

R E L A C I O N

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.102/2015, “PËR SEKTORIN E GAZIT NATYROR”, TË NDRYSHUAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Në kuadër të reformës së deregullimit dhe me qëllim krijimin e lehtësirave të mëtejshme për përmirësimin e klimës së biznesit, nëpërmjet reduktimit të barrierave administrative, janë analizuar të gjitha licencat dhe lejet e përfshira në anekset 1 dhe 2, të vendimit nr.538, datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga ose nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit”, të ndryshuar.

Në përfundim të analizës, ndër të tjera, u arrit në konkluzionin se 23 licenca eliminohen.

Me anë të këtyre ndryshimeve synohet të arrihet:

- a) reduktimi i barrierave administrative;
- b) liberalizimi i tregut;
- c) përmirësimi i mëtejshëm i klimës së biznesit.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Miratimi i këtij projektligji nuk është i planifikuar në programin analitik të projektakteve të Këshillit të Ministrave për vitin 2018.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Neni 5, i ligjit nr.10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikon se “Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, si rregull, kushtet e përgjithshme të licencimit, autorizimit dhe lejimit, organi kompetent që vlerëson përmbushjen e këtyre kushteve, organi kompetent për inspektimin dhe/ose për revokimin e licencës, autorizimit dhe lejes, si dhe shkaqet e revokimit përcaktohen me ligj,

ndërsa kushtet e posaçme të licencimit, të autorizimit dhe të lejimit, dokumentet shoqëruese, që paraqiten për pajisjen me licencë, autorizim apo leje, afati i vlefshmërisë së licencës, të autorizimit dhe lejes, procedurat e shqyrtimit dhe të vendimmarrjes dhe afatet për kryerjen e tyre, si dhe procedurat e revokimit miratohen me akt nënligjor, në bazë dhe në zbatim të këtij ligji dhe të ligjit që e parashikon atë licencë, autorizim apo leje.”.

Për sa më sipër, me anë të këtij ndryshimi në ligjin nr.102/2015, të ndryshuar, propozohet shfuqizimi i licencës “Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me burimet hidrokarbure”, me kodin IV.4.B.

Me shfuqizimin e kësaj licence, ushtrimi i veprimtarisë së shërbimeve të ekspertizës dhe/ose profesionale, lidhur me burimet hidrokarbure, do të jetë i lirë.

Ndërkohë, ky projektligj parashikon se, për të ushtruar veprimtarinë studimore-projektuese, personat fizikë ose juridikë duhet të kenë të regjistruar në regjistrin tregtar, si objekt veprimtarie, kryerjen e kësaj veprimtarie dhe duhet të kenë të punësuar specialistë të pajisur me certifikatë profesionale.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është në përputhje me nenet 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektligji nuk ka si qëllim përafrimin me *acquis* të BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Me anë të këtij projektligji propozohet shfuqizimi i licencës “Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me burimet hidrokarbure”, me kodin IV.4.B.

Me shfuqizimin e kësaj licence, ushtrimi i veprimtarisë së shërbimeve të ekspertizës dhe/ose profesionale, lidhur me burimet hidrokarbure, do të jetë i lirë.

Ndërkohë, ky projektligj parashikon se, për të ushtruar veprimtarinë studimore-projektuese, personat fizikë ose juridikë duhet të kenë të regjistruar në regjistrin tregtar, si objekt veprimtarie, kryerjen e kësaj veprimtarie dhe duhet të kenë të punësuar specialistë të pajisur me certifikatë profesionale.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij ligji.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar nga strukturat përkatëse teknike të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe është bashkërenduar me institucionet e interesuara.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektligj nuk ka efekte financiare në buxhetin e shtetit.

KËSHILLI I MINISTRAVE